

Procesverbali i mbledhjes së Këshillit Bashkiak

Data: 30.09.2025 Ora: 11:00

Mbledhja drejtohet nga: Edlira Lleshi, kryetare e Këshillit

Të pranishëm: 21 këshilltarë

Pjesëmarrës nga administrata:

- Eduart Kurti, nënkryetar i Bashkisë
- Nertila Toma, shefe e Kabineti të kryetares
- Françeska Marku , specialiste Rindertimi.
- Rake Kola, Drejtorja e Financave
- Llesh Ndoci, Drejtorja e Ndhmës Ekonomike

Miratimi i rendit të ditës

Edlira Lleshi, kryetare e këshillit: Mirëdita. Duke pasur kuorumin në sallë, vijojmë me rendin e ditës, pasi mbledhja është e gjatë dhe e ngarkuar. A jeni dakord me rendin e ditës? Kush ka pyetje ose komente?

Laurin Sana, këshilltar: Kam disa kërkesa lidhur me ndriçimin e rrugëve në qytetin e Laçit. Dua gjithashtu të theksoj se pyetjet nuk mund të kufizohen vetëm me shkrim, pasi shpesh lindin gjatë mbledhjes dhe nuk marrim gjithmonë përgjigje kur i dorëzojmë paraprakisht.

Edlira Lleshi, kryetare e këshillit: Mbledhjet po zgjaten shumë për shkak të pyetjeve jashtë rendit. Për këtë arsye, propozoj që çdo pyetje të bëhet me shkrim, në mënyrë që në mbledhjen pasardhëse të futet në rend dite dhe të përgjigjet personi përgjegjës nga bashkia. Vetëm kështu ruhet qartësia dhe rendi i mbledhjes.

Eduart Kurti, nënkryetar i Bashkisë: Çdo drejtor mban përgjegjësi për fushën që mbulon dhe është i detyruar të japë përgjigje. Pyetjet e dorëzuara paraprakisht sigurojnë që përgjigjet të jepen nga strukturat përkatëse sipas rendit të ditës.

Anton Kolziu, këshilltar: Pika “Të ndryshme” është menduar pikërisht për pyetje të tilla. Nëse kufizohemi vetëm me shkrim, atëherë çështje të thjeshta mbeten pa zgjidhje

deri në mbledhjen tjetër. Mund të ketë edhe disa pyetje të menjëhershme që duan një përgjigje të thjeshtë “po” ose “jo”, prandaj duhet të vazhdojmë si deri tani.

Edlira Lleshi, kryetare e këshillit: E kuptoj shqetësimin tuaj, por mbledhja nuk mund të kthehet në një bisedë të pafundme pyetjesh. Praktika më e drejtë është që kërkesat të depozitohen me shkrim, të futen në rendin e ditës dhe të marrin përgjigje konkrete nga bashkia.

Edlira Lleshi, kryetare e këshillit: Mbledhja bëhet mbi bazën e rendit të ditës dhe është e rëndësishme që t'i përmbahemi atij. Nuk është normale që çdo mbledhje të shndërrohet në pyetje e përgjigje pa fund, ndaj kërkesat të bëhen me shkrim dhe të futen në rendin e mbledhjes pasardhëse. Kështu sigurohemi që çdo çështje të ketë përgjigjen e duhur nga personat përgjegjës. Kalojmë te sekretari për procedurën e votimit të rendit të ditës. A jeni dakord me këtë rend dite?

Votuan 20 keshilltare pro, 0 kundër dhe 0 abstenim. Rendi i ditës miratohet me shumicë votash.

Pika 1: Projekt-vendimi për Miratimin e Ndhmës Ekonomike 6%, Gusht 2025

Edlira Lleshi, kryetare e këshillit: Vazhdojmë me rendin e ditës, pika e parë, projekt-vendim për miratimin e ndihmës ekonomike muaji gusht 2025. Ha drejtor, do me na thënë ndonjë fjalë, apo e hedhim votim? Një informacion të shkurtër, vazhdojmë me informacionin.

Aida Skeja, Këshilltare: E nderuar kryetare e këshillit, unë kam pyetje nëse më lejohet.

Edlira Lleshi, kryetare e këshillit: Prit e nderuar Aida.

Aida Skeja, Këshilltare: Unë në fakt doja të shtoja diçka lidhur me pikën e parë të rendit të ditës. Jam **pro ndihmës ekonomike**, por është mirë që të trajtohen rastet ashtu siç duhet, pra personat që **vërtetë kanë nevojë**. Kam hasur plot qytetarë që nuk kanë arritur të përfitojnë. Lidhur me kriteret e fondeve shtesë (vendim nr. 260 në Laç, 18/2024), na vijnë disa lista ku personat futen në skemë, por nuk kanë **emër, atësi, mbiemër** të plotë. Këto janë gjëra teknike dhe duhen parë, pasi përfitues duhet të jenë vetëm ata që e meritojnë. Unë besoj se kjo duhet të jetë në ndërgjegjen e çdo punonjësi.

Edlira Lleshi, kryetare e këshillit: Shumë dakord. A ke emra konkretë?

Eduart Kurti, nënkryetar i bashkisë: Na jep një emër, kujt i referohesh?

Aida Skeja, Këshilltare: Po, për shembull, janë futur Bujar Pasho (pa atësi), Majlinda Çoba, Meridita Xhetaj, Medjan Tafa, Armilleshi. Le të jenë me emër, mbiemër të plotë. Kam kërkuar që të bëhet **rakordimi me zyrën e punës** për personat që janë të aftë për punë, pra ta dimë moshën, mbase është 25 apo 30 vjeçar dhe merr një ndihmë. Unë nuk jam kundër ndihmës ekonomike, faleminderit.

Edlira Lleshi, kryetare e këshillit: Atëherë, Zoti Drejtor.

Llesh Ndoci, Drejtori i Ndihmës Ekonomike: Ju jap informacion të shkurtër. Kur bëhet fjalë për aludime ose vërejtje, na jepni një familje konkrete (në Laç, Milot, Mamurras, Kushkuqe) ta kalojmë në verifikim. Numri i familjeve fituese po ulet: kemi qenë 1160, tani janë **1110 familje** me njësi. Në bazë të vendimit nr. 8, datë 26/08/2025, janë 837 familje përfituese këtë muaj.

Edlira Lleshi, kryetare e këshillit: Po drejtor, të lutem, nuk ka nevojë të relatosh gjatë.

Llesh Ndoci, Drejtori i Ndihmës Ekonomike: Unë thashë që kemi miratuar kriteret e përfshirjes me numër protokoli 260 në 20, 18/1/2024. Ne jemi **brenda ligjit** dhe kërkoj miratimin tuaj.

Aida Skeja, Këshilltare: Dakord. Unë po ju këshilloj të lutem, që këta familje që kanë hyrë në ndihmën ekonomike këtë muaj, **le të verifikohen** të gjitha ato pika që kemi diskutuar.

Llesh Ndoci, Drejtori i Ndihmës Ekonomike: Administratorët kanë klasifikuar 36 familje grave të vetmuara (me një fëmijë e sipër) që futen në. Kemi dhe **35 persona të vetmuar** deri në moshën para-pensionit. Kemi 17 familje të divorcuara, por këto 17-të janë zgjedhur ato me më shumë probleme (me pesë fëmijë, me dhunë, me shtëpi të djegur, me probleme psikike).

Aida Skeja, Këshilltare: Nuk është nevoja, unë e citova vetë dhe në krye të herës e kam cituar në çdo mbledhje.

Llesh Ndoci, Drejtori i Ndihmës Ekonomike: Në qoftë se keni një familje me emër e mbiemër që është në zonën ku banoni ju dhe është ekonomisht shumë mirë e ka fituar ndihmën, mirëpresim dhe e verifikojmë e mbajmë shënim.

Eduart Kurti, nënkryetar i bashkisë: Të nderuar këshilltarë, nëse zotëria ka aplikuar në sistem dhe ka pikë të pamjaftueshme, siç e kemi shpjegimin, do të marrim emrin dhe do të verifikojmë.

Gëzime Veseli, Këshilltare: Sipas kriterëve duhet verifikim në terren. Ke shkuar ke verifikuar zotin **Medjan Tafa**, që e keni futur në?

Eduart Kurti, nënkryetar i bashkisë: Ne do t'i kërkojmë informacion drejtorisë së Mamurrasit të ndihmës dhe Drejtorit.

Gëzime Veseli, Këshilltare: Atë person e njeh mirë, s'ke nevojë për verifikim fare ti edhe unë. Është përfitues.

Eduart Kurti, nënkryetar i bashkisë: Do ta verifikojmë dhe **mbledhjen e ardhshme do ju kthejmë përgjigje.**

Gëzime Veseli, Këshilltare: Kërkoj informacion pse është futur, pse është përfitues. Ju kemi thënë dhe radhën tjetër, bashkangjitin letra, dokumentat pse nuk i ka zotëria.

Eduart Kurti, nënkryetar i bashkisë: Atë po bënte, po shpjegonte drejtori, vazhdoj shpjegimin për rastet që ju keni kundërshtime.

Gëzime Veseli, Këshilltare: Nëse drejtori po shpjegonte, të vazhdojë shpjegimin për zotin Medjan Tafa, të lutem.

Eduart Kurti, nënkryetar i bashkisë: Unë po i marr shpjegim edhe do t'i kërkojmë komisionit ekonomik. Shpjegimi ky ishte, shpjegim të detajuar do të japim mbledhjen tjetër pasi të marrim parasysh rastin, dhe nëse është për t'u hequr, do ta heqim.

Znj. Gëzime Veseli, Këshilltare: Të gjitha informacionin dhe **procesverbali i verifikimit** duhet të ishte në këtë mbledhje. Pse nuk kanë ardhur?

Eduart Kurti, nënkryetar i bashkisë: Po do ta sjellim procesverbalin. Por duhet të keni parasysh si praktikë që çdo qytetari i lind e drejta të aplikojë në sistem. Është refuzuar nga sistemi, në moment që refuzohet nga sistemi i lind e drejta të **futet në.**

Znj. Gëzime Veseli, Këshilltare: Po a është bërë verifikimi në këtë familje? A e dini a është i aftë zotëria për punë? Pse mos është dhe në shkollë të lartë?

Eduart Kurti, nënkryetar i bashkisë: Në këtë rast, këtë informacion ne nuk e kemi tani.

Nertila Toma, kabineti i kryetarit: E nderuar këshilltare, për sa kohë është e përfshirë në projekt-vendim, do të thotë që është bërë një procesverbal verifikimi dhe do të mbajë përgjegjësi personi që e ka bërë. Procesverbali total do të vijë në radhën tjetër të këshillit.

Gëzime Veseli, Këshilltare: Unë nuk bëj telefonata, bëj pyetje këtu ju lutem. Për zotërinë dua **verifikim në mbledhjen e ardhshme.**

Albert Ndoci, Këshilltar: Më vjen qejfi që po bëhet debat konkret. Përndryshe, nuk ia vlen më që ta diskutojmë këtë punë, hedhim në votim.

Etmond Stojani, Këshilltar: Desha t'i kërkoj drejtorit edhe për një emër tjetër, **Davë Legisi,** mbajeni shënim dhe na jepni informacion mbledhjen tjetër. A është e mundur me na dhënë **përgjigjen me shkrim** mbledhjen e radhës?

Eduart Kurti, nënkryetar i bashkisë: Davë Legisi, në rregull.

Llesh Ndoci, Drejtori i Ndihmës Ekonomike: ka kaluar aplikim njëherë në gjashtë muaj, njëherë në ditë kalojnë aplikim, për të marrë informacion...

Gjele Stojani, Këshilltar: Pse futet një muaj, po një muaj jo?

Edlira Lleshi, kryetare e këshillit: Përgjigje me shkrim mbledhjen tjetër. Hedhim votim! Kush është pro për kalimin e ndihmës ekonomike për muajin gusht 2025? Arbër të lutem shikoj kush është pro, kush është kundër.

Vendimi: Miratohet me 20 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim ndihma ekonomike muaj Gusht 2025. Kalojmë te pika dy. Emri i Zotit Meridian Tafa për t'u verifikuar.

Pika 2: Projekt-vendimi për Miratimin e Projekt-dokumentit, Faza e Dytë, Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2026-2028 i Bashkisë Kurbin

Edlira Lleshi, kryetare e këshillit: Projekt-vendim për miratimin e projekt-dokumentit, faza e dytë, Programi Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 i Bashkisë Kurbin.

Rake Kola, drejtoresha e financave: Sektori i buxhetit ka përgatitur projekt-dokumentin e PBA 2026-2028, bazuar në ligjet dhe udhëzimet përkatëse. Të ardhurat e parashikuara për Bashkinë Kurbin për 2026-2028 përfshijnë të ardhurat e veta, taksat e ndara dhe transfertat (e përgjithshme, sektoriale, të kushtëzuara). Në mënyrë përmbledhëse, totali i burimeve për

Bashkinë Kurbin për vitin 2026 arrin në (në mijëra lekë), dhe në 2027 arrin në .
Faleminderit!

Edlira Lleshi, kryetare e këshillit: Faleminderit. Pyetje? Diskutime?

Etmond Stojani, Këshilltar: Kam dy pyetje. Së pari, në faqen numër 11, thotë sikur janë 607 specialistë. Kemi shtuar specialistë të ASHK-së që bëjnë legalizimet? Nuk i keni pasqyruar këtu. Së dyti, kemi kaluar një **Qendër Ditore për të Moshuarit**. A funksionon aktualisht dhe ku ndodhet kjo qendër? Çfarë përfitimesh mund të kenë të moshuarit aty?

Eduart Kurti, nënkryetar i bashkisë: Po filloj nga pyetja e dytë. Qendra për të moshuarit në Laç funksionon, është tek Pallati i Kulturës, kati i parë, ngjitur me sheshin. Aktualisht është plot me të moshuar që luajnë letra, domino. Atyre u shërbehet çaj, kafe, ujë. Qendra u fitua me një projekt bashkëpunimi me Ministrinë e Kulturës dhe Mirëqenies; pagesat e punonjësve për një vit i kanë bërë ata, dhe për vitin tjetër (2026) do t'i paraqesim në buxhet për t'i miratuar si punonjëse me kontratë të pjesshme. Qendra ditore është funksionale që nga dita e parë.

Eduart Kurti, nënkryetar i bashkisë (për specialistët): Specialistët e ASHK-së kanë ardhur me VKM. Me shkrirjen e njësive, punonjësit kaluan pranë bashkive për të lehtësuar punën e ASHK-së dhe për të ndihmuar qytetarët. Afati është për një vit. Patjetër që do t'i sjellim në Këshill për miratim me emra dhe strukturë organike.

Rake Kola, drejtoresha e financave: Këta punonjës janë përfshirë brenda numrit total të punonjësve të Bashkisë, pasi struktura e re është krijuar si e përkohshme. Ato janë program i administrimit.

Etmond Stojani, Këshilltar: Në projekt-vendimin që keni sjellë (nr. 25-9/2024) shifra është 607, por nuk i keni përfshirë ata. Mos keni bërë *copy-paste* nga të vjetrat?

Rake Kola, drejtoresha e financave: Në shtator janë miratuar për t'u shtuar, ndërsa në dhjetor është miratuar struktura e 2025-s, dhe kjo strukturë e ASHK-së është **brenda numrit total të punonjësve të Bashkisë** dhe e programit të administrimit.

Eduart Kurti, nënkryetar i bashkisë: Mos e vritni trurin; numri total miratohet kaq. Edhe nëse ka vakanca, ne nuk e shtojmë si numër, ai numër ngelet.

Sabaete Hidri, Këshilltar: U fokusova tek plani i investimeve 2025-2027. Gjatë gjashtëmuajorit të parë të 2025-ës asgjë nuk u vu në zbatim për arsye të fushatës zgjedhore. A do të fillojë ndonjë nga këto projekte brenda 2025-ës? Konkretisht, jam e interesuar për rrugën nga Kisha te Lapidari.

Eduart Kurti, nënkryetar i bashkisë: Sipas buxhetit të miratuar, të gjitha rrugët e planifikuara (rreth 20) janë futur në buxhet. Aktualisht jemi në fazën e lidhjes së kontratës me hartuesin e projektit. Sipas afatit, brenda **muajit tetor** do të përfundojnë të gjitha projektet dhe më pas do të hidhen në sistemin e prokurimeve. Shpresojmë shumë që realizimin e investimeve ta kapim brenda këtij viti.

Rinaldo Piroli, Këshilltar: Edhe unë për asfaltimin e rrugës së rezervuarit desha të pyes. Shpresojmë të mbyllet.

Anton Kolziu, Këshilltar: Nga këto rrugë që priten të tenderohen, a ka rrugë të tenderuara që pritet të fillojnë punimet?

Eduart Kurti, nënkryetar i bashkisë: Po, është **rruga e poligonit**, e cila për momentin është në lidhje të kontratës së mbikëqyrësit. Shpresojmë që brenda kësaj jave të shpallim fituesin e mbikëqyrjes dhe të fillojë puna.

Laurin Sana, Këshilltar: Po për rrugët e Gjormit ka ndonjë të re? Procesin e di, por kam tre muaj që bëj të njëjtën pyetje. Me këtë ritëm, gati nuk del koha për t'i bërë brenda 2025-ës. A është e vërtetë që keni kryer punime gjatë fushatës elektorale?

Eduart Kurti, nënkryetar i bashkisë: Nuk janë të vërteta ato, jemi të monitoruar. Për rrugët, kemi firmosur kontratë me firmën projektuese dhe deri në fund të muajit tetor do të dorëzohen projektet. Më pas do t'i tenderojmë. Shpresojmë shumë ta kapim brenda vitit buxhetor (31 dhjetor). Duhet të keni parasysh se prokurimet kanë afate dhe procedura që duhet t'i respektojmë.

Laurin Sana, Këshilltar: Po pra, po mund të vijmë fiks mbas një viti dhe mund të kemi prapë të njëjtat përgjigje.

Eduart Kurti, nënkryetar i bashkisë: Kjo bashki dhe kjo kryetare bashkie ka marrë përsipër me iniciativë 20 rrugë që të shtrohen brenda një viti, kaq shumë investime nuk janë miratuar ndonjëherë.

Aida Skeja, Këshilltare: Nisur nga shqetësimet e qytetarëve, sugjeroj që në këtë plan buxhetor të kihet parasysh dy pika jetike: E para është **përmirësimi i infrastrukturës** (në zonat urbane dhe rurale), dhe e dyta është **rehabilitimi dhe menaxhimi i mbetjeve**.

Eduart Kurti, nënkryetar i bashkisë: Patjetër, përmirësimi i infrastrukturës zë një zë të rëndësishëm në investime. Për menaxhimin e mbetjeve, jemi zbatues të një rishikimi të ligjit nga qeveria. Ne do të përmirësojmë punën me operatorët dhe do të shtojmë kërkesën e llogarisë për të gjitha njësitë, si dhe do të përmirësojmë sistemin e koshave. Të dyja këto do të jenë në vëmendjen kryesore.

Agron Ivani, Këshilltar: Kur do të realizohen koshat që janë premtuar tash dy vjet në Fushkuqe? A është e parashikuar rruga e Alkut?

Eduart Kurti, nënkryetar i bashkisë: Koshat janë në fazën e lidhjes së kontratave dhe besoj brenda **muajit tetor** do të shpërndahen në zonën e Fushkuqes. Rruga e Alkut është e parashikuar.

Agron Ivani, Këshilltar: E dimë se e kemi votuar, por kur realizohet? Projektuesi do t'i bëjë të gjitha? Deri tani shoh që gjithçka bëhet në Laç, dhe njësitë janë lënë mbas dore.

Eduart Kurti, nënkryetar i bashkisë: Projektuesi do të zbatojë të gjitha investimet që janë detyrë projektimi. Jemi në tetor, po flas mbi dokumente. Përgjegjësitë janë marrë dhe dokumentat janë në proces. Duhet të keni pak durim.

Aleksandër Jakaj, Këshilltar: Tek shkolla e mesme në Gorre dhe shkolla nëntëvjeçare **nuk ka sinjalistikë** dhe vizime në rrugë.

Eduart Kurti, nënkryetar i bashkisë: Ne i kemi ndarë në buxhetin rrugor. Do të marrim masat, do të bëjmë prokurimin e nevojshëm për blerjen dhe vendosjen e sinjalistikave. Do ta mbaj si shqetësim dhe do ta bisedoj.

Etmond Stojani, Këshilltar: Në buxhetin afatmesëm kemi asfaltim **unaza e Mamurrasit** dhe **rrugët e Gjormit**. A është rruga e Gjormit ajo e agroturizmit? Gjithashtu, do të isha dakord sikur të pastroheshin **varrezat e Mamurrasit** para se të bëhen punime (solli foto në WhatsApp si

shembull). Për rrugën e **Tukëve** janë parashikuar të reja. Kjo vlerë nuk mjafton as për çakëll.

Eduart Kurti, nënkryetar i bashkisë: Për varrezat, është e vërtetë, nuk kanë punëtorë specifikë. Operatorët e shërbimeve veprojnë sipas planifikimit. Në Mamurras aktualisht nuk ka operator pastrimi. Do ta shikojmë këtë në kontratat e ardhshme. Për rrugën e Tukëve, ne e kemi futur me dëshirën e mirë për ta filluar. Nëse do të kërkohet një shtesë buxheti, do të vijmë prapë pranë jush për miratim.

Albert Ndoci, Këshilltar: Një nga problematikat më të mëdha të Kurbinit është **rindërtimi**. Ka njerëz që jetojnë në Dubai dhe kanë marrë shtëpi, kurse ka njerëz që nuk pyet kush për ta.

Sefedin Lika, Këshilltar: Sa i përket njësise Milot, **Qendra e Pazarit** është me gropa, duhet të merrni masa. Për fshatrat, kemi miratuar tre rrugë (rrugën e Telit, rrugën e fshatit Malbardhë). Mos ta lëmë pas dore Milotin.

Eduart Kurti, nënkryetar i bashkisë: Për Milotin, është një projekt madhor. Lidhje e unazës dhe rruga që lidh me tregun do të zbatohet nga **Fondi Shqiptar i Zhvillimit** (FSHZH). FSHZH-ja po bën dhe një rishikim të projektit për rindërtimin e tregut modern. Për rrugët rurale, jemi në proces hartimi të projekteve dhe presim që të financohen pas mbarimit të projektit. Afati i firmës për hartimin e projekteve është **30 ditë**.

Edlira Lleshi, kryetare e këshillit: Hedhim votim! Kush është pro?

Vendimi: *Miratohet projekt-vendimi për miratimin e projekt-dokumentit, faza e dytë, Programi Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 i Bashkisë Kurbin me 17 vota pro, 4 vota kundër dhe 0 abstenim.*

Pika 3: Projekt-vendim për Miratimin e një Ndhime Financiare për Disa Familje

Eduart Kurti, nënkryetar i bashkisë: Kërkoj mirëkuptim, të mbarojmë dhe me Raken. Është edhe kjo pika për ndihmë financiare që të lëvizë. Mund ta bëjmë këtë?

Edlira Lleshi, kryetare e këshillit: Po, projekt-vendim për miratimin e një ndihme financiare për disa familje. Rake, janë tre familje.

Eduart Kurti, nënkryetar i bashkisë: Ok, po e shpjegoj shkurtimisht. Janë tre familje të propozuara: **Agron Duka**, **Kastriot Gjoni** dhe **Gani Hidri**. **Kastriot Gjoni** nga Gorreja është në varfëri ekstreme, ka dy fëmijë me autizëm. Përveç ndihmës, Kryetarja ka bërë dhe një apel për firmat që mund të kontribuojnë për t'i restauruar shtëpinë. **Agron Duka** është këtu prezent, ka për të operuar fëmijën (një operim në kokë) që është shumë i kushtueshëm. Dhe **Gani Hidri** nga Miloti, ka gjithashtu një operim shumë të vështirë. Ne mundohemi me sadopak t'i zbusim hallet e tyre.

Edlira Lleshi, kryetare e këshillit: Kemi pyetje?

Diogjen Kolici, Këshilltar: Faleminderit zonja kryetare. Unë i njoh situatat e dy prej tre familjeve dhe normalisht nuk e marr fjalën për të qenë kundër. Por do të doja, nëse është e

mundur, që dikush nga administrata të më përshkruajë në rend kronologjik, **si administrohet një kërkesë për ndihmë financiare** nga familja, pra hap pas hapi çfarë ndodh derisa vjen në Këshillin Bashkiak për miratim.

Eduart Kurti, nënkryetar i bashkisë: Është zyra e shërbimit social. Po, ja do shpjegoj Tila se është dhe ish-punonjëse.

Nertila Toma, kabineti i kryetarit: Familja me vështirësi ekonomike i drejtohet sporteleve tona me një kërkesë me shkrim pranë protokollit të bashkisë. Shërbimi Social brenda 48 orësh **verifikon në familje** vështirësinë ekonomike dhe mbledh dokumentacionin (mjekësor apo ekonomik). Ne vlerësojmë llojin e problematikës dhe, në rakordim me Financën, shohim buxhetin. Këto tre raste i paraqitëm pasi janë konsideruar **alarmante** (kanë operacione dhe janë në kushte ekstreme ekonomike).

Diogjen Kolici, Këshilltar: Është e qartë deri këtu. Në momentin që bëni përzgjedhjen, a ka një **listë prioritetesh** apo një fashë aplikimi (p.sh., tre muaj aplikojnë X familje dhe pastaj prioritizohen)? Kjo sepse ka familje që kanë aplikuar për më shumë se një vit.

Nertila Toma, kabineti i kryetarit: Unë kam deri më tani **120 kërkesa** për ndihmë financiare për vitin 2025 (nga janari). Në momentin që rasti konsiderohet **alarmant** (siç janë këto tre rastet me operacione e vështirësi ekstreme), e paraqesim para jush. Raste të tjera i kemi vlerësuar, por nuk janë në kushtet e këtyre.

Diogjen Kolici, Këshilltar: Pse jepen tre sot kur kanë aplikuar 125?

Nertila Toma, kabineti i kryetarit: Në varësi të buxhetit të Financës. Nëse Financat më thonë që kemi fonde për të gjitha 125 dhe plotësojnë kushtet, sigurisht që do të paguhen. Nëse nuk ka fond, do të marrim **prioritetet**, kush është në vështirësi më të madhe.

Diogjen Kolici, Këshilltar: Nuk e kam për një rast në veçanti, por unë propozoj që të ketë një farë sistemi ku mblidhen aplikimet, mos jetë subjektive.

Nertila Toma, kabineti i kryetarit: Sistemi është koordinuar në mënyrë perfekte siç ta shpjegoja. Nuk është e parashikuar në ligj që të kemi një (si ndihma ekonomike) që vjen në Këshill, kemi një **strukturë të posaçme** që merret me verifikim.

Edlira Lleshi, kryetare e këshillit: Ideja e Diogjenit është që mos të jetë relative. Kjo është **ndihmë financiare që nuk parashikohet në ligj si strukturë**. Unë mund të mendoj që këto tre kanë nevojë, por financa thotë se për këtë muaj nuk mund të shpenzojmë më shumë se kaq lekë.

Aida Skeja, Këshilltare: Do të marrësh prioritetin, këtu ke më problem. Sugjeroj të merrni në konsideratë familjen **Mirela Lilaj** me një fëmijë, të cilën e keni trajtuar, por fotot e gjendjes së tyre janë vërtet për të ardhur keq. Duhet të ketë një lloj **transparence**.

Edlira Lleshi, kryetare e këshillit: Shumë dakord. Këta persona ne ua kemi dhënë ndonjëherë ndihmën, i kemi miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak. Kjo është çështje procedure. Ne do t'i hedhim njëherë në votim këta tre familjet.

Sefedin Lika, Këshilltar: Unë e kam marrë në telefon dhe e kam takuar njërin prej përfituesve, **Agron Duka** (i komunitetit egjiptian). Në respekt të tyre, janë një komunitet që janë lënë shumë pas dore. Varfëria është shumë e madhe. Ne nuk duhet të bëjmë dallime dhe diferencime.

Eduart Kurti, nënkryetar i bashkisë: I nderuar këshilltar, nuk bëhen dallime dhe diferencime. Janë qytetarë të barabartë të Kurbinut. Ne nuk i ndajmë kështu qytetarët, nuk është as ligjore.

Edlira Lleshi, kryetare e këshillit: Do ta hedhim votim. Kush është pro?

Vendimi: *Miratohet projekt-vendimi për dhënien e ndihmave financiare për tre familjet me 21 vota pro, 0 kundër dhe 0 abstenim.*

Pika 4: Projekt-vendimi për Miratimin e Listës së Përfituesve që kanë Aplikuar në Platformën "Shtëpia Ime" (Rindërtimi)

(Shënim: Largohen nga mbledhja Anton Kolziu dhe Aleksandër Jakaj mbasi kërkuar fjalën dhe nuk e morën.)

Edlira Lleshi, kryetare e këshillit: Fjala është dhënë sa herë ke kërkuar. Në qoftë se ti do me gjet një skuzë me dalë nga mbledhja, është një gjë koti. Ju duhet të rrini deri në fund të mbledhjes siç kërkon tani kur flasim. Duhet pak më seriozitet. Kalojmë te projekt-vendimi. Projekt-vendim për miratimin e listës së përfituesve që kanë aplikuar në platformën "**Shtëpia Ime**", programi i zhvillimit të objekteve të reja.

Françeska Marku, punonjëse e drejtorisë së rindërtimit: Unë si anëtare e komisionit të posaçëm vij përpara jush për të paraqitur projekt-vendimin për miratimin e listës së përfituesve që kanë aplikuar në platformën online "Shtëpia Ime" për programet e procesit të rindërtimit. Komisioni i posaçëm, bazuar në vendimin 904 dhe aktet normative, ka shqyrtuar dokumentacionin e depozituar. Është një listë me **gjashtë familje**.

Edlira Lleshi, kryetare e këshillit: Të lutem Françeska, na thuaj pse janë gjashtë, dhe cilat janë kriteret si në rastin e ndihmës ekonomike.

Françeska Marku, punonjëse e drejtorisë së rindërtimit: Janë gjashtë familje të cilat kanë depozituar me **vonesë dokumentacionin e munguar** në dosje, pasi pjesa tjetër është miratuar. Këshilltarët janë njohur paraprakisht me vendimin.

Albert Ndoci, Këshilltar: Në lidhje me personat që kanë aplikuar, a duhet të aplikojnë të gjithë ata që janë pa shtëpi? **Procesi i rindërtimit është procesi më gangrenoz.** Ka me qindra familje që ju kanë rënë tjegullat e gurët dhe nuk përfitojnë, kurse të tjerëve u janë bërë shtëpia. Nuk do të

diskutoj më, kam përgatitur **tre kallëzime penale** në SPAK, dhe as do ta pranoj as do ta votoj këtë pikë.

Françeska Marku, punonjëse e drejtorisë së rindërtimit (Përgjigje për aplikimin):

Platforma online "Shtëpia Ime" është hapur në tre faza aplikimi (Shkurt, Korrik, Dhjetor 2020). Të gjitha familjet që kanë patur dëmtime kanë aplikuar. Nuk mund të përfshihen në programet e rindërtimit familjet që **nuk janë aplikuese**, sepse aplikimi është kusht themelor.

Albert Ndoci, Këshilltar: Për qytetarët ju jeni shembull i keq, keni prishur pallate kot dhe nuk i keni ndërtuar akoma.

Sabaete Hidri, Këshilltare: Nuk kam asnjë kundërshtim që të miratohen të gjitha familjet. Por kam një pyetje: Pse nuk bëhet **fasada e dy pallateve në oborr të Kishës**? Më vjen turp nga qytetarët që banojnë aty. Punojnë në administratën shtetërore e në Bashki. Pse nuk po bëhen ato dy pallate, ndërsa të tjerat u bënë?

Eduart Kurti, nënkryetar i bashkisë: Të dy ato pallate i përkasin një **shkallë dëmtueshmërie shumë të ulët (DS1)**, pra të parrezikshme. Në këto raste aplikohet përmirësimi i infrastrukturës së jashtme (fasada). Kërkesa i është drejtuar Ministrisë për fond. Jemi në pritje të buxhetit dhe do t'i nënshtrohen riparimit.

Sabaete Hidri, Këshilltare: Unë kur kam folur me ju më keni thënë se do të bëhet, tani do ta bëj me shkrim. Pallatet e Kooperativës u mbaruan, dy pallatet tona kanë ngelur.

Eduart Kurti, nënkryetar i bashkisë: Ke shumë të drejtë për shqetësimin, ato janë në proces. Fasada nuk kanë mbaruar, do bëhen. Shkalla e dëmtueshmërisë së tyre është DS1, thjesht riparim fasade, vetëm sa të vijë buxheti.

Edlira Lleshi, kryetare e këshillit: Pse janë vetëm gjashtë? A s'ka aplikuar tjetër kush?

Françeska Marku, punonjëse e drejtorisë së rindërtimit: Urdhëro, janë gjashtë dosje të cilat janë **plotësuar dokumentacioni i munguar** (me vonesë).

Erisa Gjonaj, Këshilltare: Ka rënë në 2019, jemi në 2026. Ajo shtëpi që është kthyer në vend rreziku akoma nuk është rindërtuar.

Nertila Toma, kabineti i kryetarit: Na jep emrin Erisa, të marrim informacionin nga personi përgjegjës që ka për detyrë të ndjekë kontratën me firmën e ndërtimit.

Eri Zymaj, Këshilltar: Për një person që nuk është përfitues, mund të ma japësh përgjigjen pse nuk është përfitues?

Nertila Toma, kabineti i kryetarit: Qytetari e ka marrë përgjigjen me shkrim. Është çështje **interpretimi** që ai ka bërë. Është edhe Ministria e Infrastrukturës në dijeni të gjithë kësaj gjëje dhe kërkohet një interpretim ligjor, që edhe ne të jemi në rregull për ta kaluar.

Eri Zymaj, Këshilltar: Ka ndonjë afat kjo pjesë?

Nertila Toma, kabineti i kryetarit: Do të presim, kemi kërkuar interpretim nga Ministria e Infrastrukturës.

Edlira Lleshi, kryetare e këshillit: Paskan hyrë instanca më të larta se ne. E hedhim në votim projektin për këto gjashtë familje. Kush është pro?

Vendimi: *Miratohet projekti i rindërtimit për këto gjashtë familje me 16 vota pro, 0 kundër dhe 0 abstenim.*

Pika 5: Diskutimi i Kodit të Sjelljes dhe Parandalimit të Konfliktit të Interesit

Edlira Lleshi, kryetare e këshillit: Pika e fundit, diskutimi i Kodit të Sjelljes dhe parandalimit të konfliktit të interesave të Këshillit Bashkiak.

Arbër Leka, Sekretari i Këshillit: I nderuar nënkryetar, e nderuar kryetare dhe këshilltarë. Ky kod është miratuar me rregulloren e përgjithshme, nuk kërkon miratim sot, është thjesht për diskutim. E pamë të arsyeshme t'ju rikujtojmë, duke u nisur nga keqkuptimi që ndodhi në mbledhjen e kaluar kur as unë dhe as Kryetarja nuk ishim prezentë. Kemi një kod etike që duhet zbatuar dhe duhet të flasim brenda rregullores së Këshillit. Jemi të zgjedhurit e 75,800 banorëve të Kurbinit, por duhen zbatuar disa rregulla. Do të bëjmë një **trajnim** javën tjetër për të gjithë këshilltarët, ku do të njihemi më shumë me katër rregulloret e përgjithshme të miratuara. A ka ndonjë diskutim apo pyetje për Kodin e Etikës?

Albert Ndoci, Këshilltar: Përsa i përket Kodit të Etikës dhe **Konfliktit të Interesit**, ju falënderoj që pas dy vitesh e gjysmë po merrni masa. Ajo kod etike është bërë vetëm për mua. Unë nuk do të flas dhe nuk do të bërtas më, çdo gjë keni me shkrim e me kallëzim. **Konflikt interesi kemi me shumicë në Bashki.** Kryetarja e Bashkisë ka burrin, Drejtoresha e Financës ka gocën, janë burrë e grua; sa të duash ke. Mos u afroni te ne. Rregulloni punët e brendshme, mos na thoni nesër që "e ka miratuar Këshilli" për të shpëtuar veten. Unë do të dal sepse nuk mund të diskutoj për kod etike për ato të Bashkisë Kurbin.

Arbër Leka, Sekretari i Këshillit: Në radhë të parë, ta cilësova më sipër, ky kod **nuk kërkon miratim**. Është miratuar në mbledhjen e dytë të këtij Këshilli Bashkiak së bashku me të gjitha rregulloret e tjera. Ju e keni në dosje dhe është i afishuar në faqen e Këshillit.

Albert Ndoci, Këshilltar: Ky kod është turp. Unë kam ngritur flamurin, kam histori në këtë Kurbin, dhe ju nuk mund të merreni me mua.

Arbër Leka, Sekretari i Këshillit: Herën tjetër zoti Ndoci, më vjen keq, por **Kryesia e Këshillit do të marrë masa**. Të lutem.

Pika 6: Të ndryshme

Etmond Stojani, Këshilltar: T'u japim fjalën atyre dy qytetarëve, të kemi pesë minuta kohë.

Edlira Lleshi, kryetare e këshillit: Për çfarë tashi, për të ndryshmet?

Etmond Stojani, Këshilltar: Qytetarët flasin, dhe të ndryshmet i lëmë për në fund.

Edlira Lleshi, kryetare e këshillit: Nuk është normale kjo gjë. Për çfarë? Ti si këshilltar duhet të thuash që është ky problem.

Etmond Stojani, Këshilltar: A të shkoj ta hap arkivën te shtëpia, sa kërkesa kam pa përgjigje? Qytetarët kanë halle.

Edlira Lleshi, kryetare e këshillit: Fole në fillim të mbledhjes, ti as nuk na the gjë. I gjejmë ata dy qytetarët.

Vasil Ndoci, Qytetar: Përsëritet Kryetare e Këshillit dhe anëtarë. Unë kam problemin e shtëpisë time të prishur nga **procesi i Rindërtimit**. Kam gjashtë vite që pres, firma e zgjedhur nga Bashkia akoma s'ma ka ndërtuar.

Nertila Toma, kabineti i kryetarit: Zotërinë do ta sqarojmë në **zyrën përkatëse** direkt tani mbas mbledhjes.

Edlira Lleshi, kryetare e këshillit: Deklaroj mbylljen e mbledhjes. Laç, më 30.09.2025.

Sekretari i Këshillit

Arber LEKA